

20241031949

**АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА КАПИТАЛНО ФИНАНСИРАНО ПЕНЗИСКО
ОСИГУРУВАЊЕ**

Sipas nenit 83 paragrafi (3), nenit 84, paragrafi (1) dhe (2) dhe 87 të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm Pensional të Financuar me Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 180/2019 dhe 103/2021) dhe nenit 124, paragrafi (3), nenit 125, paragrafi (1) dhe (2) dhe 128 të Ligji të Sigurimit Vullnetar Pensional të Financuar me Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2008, 124/2010, 17/2011 dhe 13/2013 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 103/2021), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, në seancën e mbajtur më 25.4.2024, miratoi:

R R E G U L L O R E
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR VLERËSIMIN E
MJETEVE TË FONDEVE PENSIONALE TË DETYRUESHME DHE VULLNETARE

Neni 1

Në Rregulloren e Vlerësimit të Mjeteve të Fondeve Pensionale të Detyrueshme dhe Vullnetare (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 138/2008, 55/2013, 218/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 41/2019 dhe 250/2019) në nenin 6, paragrafi (3) dhe paragrafi (5) pas fjalës: “Bloomberg” vihet presje dhe shtohet fjala: “FactSet”.

Neni 2

Në nenin 8, paragrafi (1), pika a) ndryshohet dhe bëhet:

“a) fondet e hapura investuese vlerësohen sipas vlerës së aksionit të publikuar nga Komisioni i letrave me vlerë ose Bursa e Maqedonisë dhe të përcaktuara në ditën e punës që i paraprin datës së vlerësimit (T-2 ku T është dita vijuese). Si përjashtim, nëse dita T-2 është ditë jopune, si dita T-2 konsiderohet dita e fundit e mëparshme e punës”;

Pikat: “gj) dhe e)” bëhen pika: “g) dhe d)”.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr.01-646/4
26.4.2024
Shkup

Kryetari i Këshillit
të Ekspertëve,
Maksud Ali, d.v.